

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,** DEPARTAMRNTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE, me gjyqtarin Bajram Miftari, duke vendosur në çështjen juridike sipas padisë së paditësit, Kompania e Sigurimeve "I."sh.a., me seli në P., kundër te paditurit N.T.P "A." me seli në H. të E., për pagim borxhi, vlera e kontestit 4,009.91 €, me datën 10.06.2016 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**Për shkak të mosbindjes**

**I. MIRATOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, Kompania e Sigurimeve "I." me seli në P., ashtu që detyrohet i padituri N.T.P "A." me seli në H. të E..që në emër të kompensimit të borxhit paditësit'ia paguaj shumën prej 4,009.91 €, me normë të kamatës siç e aplikojnë bankat komerciale në Kosovë, për deponimet e mjeteve në bankë, në afatin prej një viti pa destinim të caktuar e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të paditës në gjykatë dt. 04.10.2014, e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

**II. DETYROHET** i padituri, që paditësit t'ia paguaj shumën prej 100.00 €, në emër të shpenzimeve te procedurës kontestimore, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

**A r s y e t i m i**

Paditësi Kompania e Sigurimeve "I." me seli në P., në këtë gjykatë me datën 10.04.2014, ka paraqitur padi kundër të paditurit N.T.P "A." me seli në H. të E.. Në padi ka theksuar sei padituri ne emër të primit për policën e sigurimit me numër 66/10 me mbulesë siguroese nga data 25.05.2010, deri me datën 24.05.2011, ka qenë i detyruar paditësit t'ia paguaj shumën prej 2,690.04. Ne emër të primit për policen e sigurimit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta me numër 002532271, me mbulesë siguroese nga data 19.04.2010, deri me datën 19.04.2011, ka qenë i detyruar t'ia paguaj paditësit shumën prej 881.60€. Ndërsa ne emër të primit për policën e sigurimit të përgjegjësisë së automjetit motorik ndaj palës së tretë, me numër 0002532268 me mbulesë sigurimi një vjeçare, ka qenë i detyruar t'ia paguaj paditësit shumën prej 881,60 €. Ka shtuar se gjithsejtë obligimi i të paditurit ndaj paditësit ne emër të primit për kontratat e lartcekura të sigurimit ka qenë në shumën prej 4,453.24 €. Me tej ka shtuar se nga të gjitha policat e sipërcituara i padituri ka bërë pagesën e vetëm 443.33 €, dhe rrjedhimisht borxhi i të paditurit ka zbritur në shumën prej 4,009.91. I ka propozuar gjykatës qe me aktgjykim ta detyron të paditurin që ne emër të borxhit të pa paguar të sipërcituara, paditësit t'ia paguaj shumën prej 4,009.91 €, me kamatë ligjore.

Me aktvendimin e datës 11.12.2015, gjykata e ka detyruar të paditurën që të paraqes përgjigje në padi. Nga fletkthesa në shkresat e lëndës shihet se të paditurit i është dorëzuar aktvendimi me dt.11.01.2016. Megjithatë, gjykatës nuk i është dorëzuar përgjigja në padi.

Me nenin 150.1 të LPK-së, është përcaktuar se në çoftë se i padituri brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj nuk paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimin për shkak të mosbindjes), po qe se janë plotësuar këto kushte:

- a) Po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi,
- b) Po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; dhe
- c) Po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Nga të dhënat në shkresat e lëndës dhe provat e parashtruara, gjykata konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjushmërisë.

Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia dhe aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi, dhe është paralajmëruar për pasojat procedurale juridike në rast të mos përgjigjes, por i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në padi, brenda afatit të paraparë me ligj.

Gjykata potencon se neni 150 i LPK-së nuk i jep detyrimin gjykatës që të vërtetoj faktet e paraqitura nga pala paditëse. Kur i padituri nuk paraqet përgjigje në padi dhe nuk i kundërshton faktet e paraqitura në padi, konsiderohet se *ex lege* i ka pohuar faktet e tilla. Andaj, vlen supozimi ligjor se ato fakte ekzistojnë dhe se nuk ka nevojë që të njëjtat të vërtetohen përmes procesit të administrimit të provave. Pra, gjykata ka pranuar faktet e pretenduara nga paditësi me padi se i njëjti me të paditurin datën 24.05.2010, kanë lidhë kontratë të sigurimit të personave nga aksidentet personal, me mbulesa siguruese e cila ka qenë nga data 25.05.2010 deri me 24.05.2011, ku paditësi ka marr detyrim që në emër të primit të sigurimit paditësit t'ia paguaj shumën prej 2,690.04 €. Me datën 19.04.2010, të njëjtit kanë lidhur kontratë tjetër të sigurimi nga autopërgjegjësia me mbulesë siguruese nga data 19.04.2010, deri me datën 19.04.2011, ku i padituri ka marr detyrim që në emër të primit të sigurimit paditësit t'ia paguaj shumën prej 881.60 €. Me datën 19.04.2010, ndërgjyqësit kanë lidh kontratën e tretë të sigurimit nga autopërgjegjësia, me mbulesë siguruese nga data 19.04.2010 deri me datën 19.04.2011, ku i padituri ka marr detyrim që në emër të primit të sigurimit paditësit t'ia paguaj shumën prej 881.60 €. Shuma e përgjithshme e borxhit të cilin i padituri ka pasur ndaj paditësit në emër të primit nga tri plocicat e lidhura të sigurimit ka qenë në shumën e përgjithshme prej 4,453.24 €.

Gjykata po ashtu ka pranuar faktet e pretenduara nga paditësi me padi se me datën 01.12.2012, palët ndërgjyqëse kanë lidhur marrëveshje për kthimin e borxhit në emër të primit të sigurimit, nga kontratat e lartëcituarat. I padituri nuk i është përmbajtur marrëveshjes pasi që i njëjti ka paguar vetëm pjesërisht borxhin, duke bërë pagesa në shumën prej 443,33€. Ndërsa ka mbetur në borxh shumën prej 4,009.91 €

Me dispozitat e nenit 17.1. të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), është përcaktuar se pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vetë dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij. Ndërsa me dispozitat e nenit 262 par.1. të LMD-së, është përcaktuar se kreditori në raportin detyrimorë është i autorizuar që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë detyrimin në mënyrë të ndërgjegjshme.

Po ashtu, gjykata ka konstatuar se faktet e paraqitura nga pala paditëse në padi nuk bien ndesh me provat e prezantuara nga paditësi dhe as me faktet e ditura botërisht.

Nga faktet e paraqitura në padi rezulton se i padituri në emër të kontratave të sigurimit të lidhura me paditësin është në borxh në shumën prej 4,009.91 €.

Gjykata e miratoi kërkesëpadinë edhe përkitazi me kamatën e vonesës së kërkuar, ashtu që e detyroi të paditurin që përveç borxhit kryesor, paditësit t'ia paguajë edhe kamatën ligjore siç e paguajnë bankat në Kosovë, për deponimet prej një viti, pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedh nga dita e ushtrimit të padisë, gjegjësisht data 05.12.2011, e deri në pagesën definitive, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së.

Gjykata, ka miratuar edhe kërkesën e paditësit për shpenzimet e procedurës kontestimore. Në nenin 452.1. të KPK-së është përcaktuar se pala e cila e humb procesin gjyqësor ka për detyrë që t'ia kompensoj palës kundërshtarë gjyqësor shpenzimet procedurale. Andaj, gjykata ia ka njohur palës paditëse shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 100.00 € të cilat i referohen taksave për padi dhe aktgjykim, dhe të njëjtat ja ka miratuar me të njëjtin aktgjykim.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe konform dispozitave të nenit 150.1 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Ekonomike**  
**I.C.nr.241/2014, me datë 10.06.2016**

Gjyqtari,  
Bajram Miftari

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi